- 19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik** 1. Për një pjesë të kriterëve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklarate, ku shprehet se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.
2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetdeklarim.
4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP).
- 20. Konvertimi në valutë të vetme** 1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

21. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Autoriteti Kontraktor përcakton ofertën ekonomike më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) – Oferta Ekonomike më e Favorshme, bazuar në kosto :

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{mink1} \times P_{maxk1} / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Opsioni 2) – Oferta Ekonomike më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: Autoriteti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

Autoriteti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomike më e favorshme

2. Autoriteti Kontraktor përdor një nga kriteret e vlerësimit një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

22. Vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve

**aritmetike dhe
ofertave
anomalisht të
ulëta**

1. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.
- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët .

3.Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4.Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Njoftimin e Kontratës, Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës.....
Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës.....
Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike
Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit
Shtojca 7. Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak).....
Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)
Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Loti 1. Materiale per marrjen e gjakut

Nr	Emertimi	Volumi, Permasat	Shenime	njesia
1	Tub me trisodium citrate plasma (0,109M,3,2% per teste koagulimi Sistem I mbyllur me vakum .Tape bojeqielli	2,7-4,5 ml,13x75mm		cope
2	Tuba me xhel per serum, me aktivator koagulimi te shpejte .Sistem I mbyllur me vakum .Tape Portokalli/e kuqe	5ml,13x100mm	Ndares me xhel ,koha e koagulimit jo me shume se 10 minuta	cope
3	Tuba me xhel me serum me aktivator kogulimi me kohe jo me te madhe se 30 minuta .Sistem I mbyllur me vakum.Tape e Verdhe/e Kuqe.	5 ml,13x 100mm	Ndares me xhel	cope
4	Tuba me litium Heparin per plazem ,Sistem I Mbyllur me vakum .Tapa Jeshile	3-4 ml,13x75mm	Ndares me xhel ose ndares mekanik	cope
5	Tuba me K2EDTA (Dipotaassium) per teste hematologjike,Sistem I mbyllur me vakum .Tape Lejla	3-4 ml,13x75mm		cope
6	Tuba me K3 EDTA ,Sistem I mbyllur me vakum .Tape Lejla	3-4 ml,13x75mm		cope
7	Tuba ACD(Acid Citrate Dextrose Tape e Verdhe	8-10 ml 16x100mm	Sasi e vogel vetem per HLA	cope
8	Tub me sodium citrat per matjen e eritrosedimentacioit (ESR) Tape e zeze	1,6-5ml	Te shoqerohet me stative mbajtes /mates ose me aparatura automatika te matjes se ESR me kapacitet jo me pak se 60 teste ne ore	cope
9	Tub pediatrik me K2/K3EDTA per hematologji	me volum 250-500 µl	Te pershtatshem per analizatoret automatik te gjakut	cope
10	Tub pediatrik me xhel per serum	me volum 400-1000 µl	Te pershtatshem per analizatoret automatik te gjakut	cope
11	Set Age per marrje gjaku ,te pershtatshem per te gjithë tubat e sistemit me vakum te ofruar	21G ,gjatesia e gjilperes 19mm, gjatesia e tubit jo me e vogel se 17cm.	Rekomandohen sisteme te ages me kapuc per te shmangur kontaminimin dhe me buton terheqes se ages per mbrojtje e personelit nga shpimi aksidental	cope
12	Shiringe per marrje gjaku me litium heparine	1-3 ml,21-22G	E pershtatshme per gazet ne gjak	cope

13	Gjilpere shpuese per marrjen e gjakut te foshnjave	23 G	Set age flutur I pershtatshem per moshat pediatrike, neonat per tubat me vakum.	cope
14	Zhgut(IIastik)per shtrengimin e krahut ku do merret gjaku			cope
15	Kontenier plastik steril per koleksionimin e urines me kapak dhe vidhosje qe mbyllet fortesisht	30-60ml ,bosh.	Gotat te jene individualisht te paketuara	cope
16	Tub me terren per transportin dhe ruajtjen e urines me permbajtje te acidit borik	4-10ml,	per transport dhe ruajtje te mostrave te urines deri ne 48 ore	cope
17	Kontenier plastik per koleksionimin e feces i pajisur me spatul dhe kapak dhe vidhosje qe mbyllet fortesisht	20-30ml bosh	Bosh	cope
18	Kontenier me terren ruajtes te pershtatshem per koleksionimin e feces per testim parazitologjik	30-40ml	terren me permbajtje 10% formaline fiksuese ose ekuivalent	cope
19	Kit per koleksionimin dhe ruajtjen e mostrave rektale dhe feces.I perbere nga tamponi dhe tubi me terren Carly Blair	Tampon me tub me terren	i rekomanduar per rastet kur mostra fekale nuk mund te sigurohet ne rruge tradicionale	cope
20	Kit steril I pershtatshem per marrjen e mostrave vaginale,fytit,te lekures ,te plageve I pajisur me tampon dhe terren ruajtes per aerobe,anaerobe.	Terren ruajtes me xhel agar Amies ose Stuart me dhe pa charcoal ose ekuivalent	Tamponet te jene me bisht plastik dhe maje me permase normale. Kiti mund te perfshije nje ose 2 tampone dhe tubin me terren. Te kene paketim individual per cdo kit.	cope

Kerkesat Teknike dhe Standartet e Sistemit te Marrjes se Gjakut ne perputhje me Teknologjine e perdorur nga Konkensionari.

1. Tubat dhe aksesoret e tubave duhet të jenë të markuara CE ose FDA për të siguruar kualitetin e produktit.
2. Tubat e gjakut duhet te jene ne perputhje me “Direktiven europiane te pajisjeve mjeksore per diagnostiken in vitro 98/79/EC” ose ekuivalente. me normat MDD. 93/42/EEC (të përditësuar) ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur eshte e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.
3. Tubat dhe aksesoret duhet te jene te sterilizuara.
4. Tubat dhe aksesoret e tubave duhet te jene e nje sistemi te mbyllur te marrjen e gjakut ne perputhje me kerkesat e OBSH dhe CLSI.
5. Tapat e tubave te jene me ngjyra te percaktuara sipas rekomandimeve te EFLM ne varesi te disiplinave laboratorike ku ato do perdoren.
6. Tapat e tubave te rutines duhet te mbyllen nga nje sistem i pajisur me nje gome unike e cila izolon tubat e mbledhjes se gjakut.Ajo duhet te jete e futur nga brenda dhe e

mbuluar nga nje mburoje plastike per te ndihmuar ne mbrojtjen e personelit mjeksor nga kontakti me gjakun ne pjesen e tapes ose ne skajet e jashtme te tubit. Nje mbyllje e tille ben te mundur qe gjaku mos sperkatet/perhapet kur tubi hapet .Te sillen mostra per tu provuar nga laborator.

7. Tubat duhet te kene te shenuar volumin e mbushjes dhe nivelin e mbushjes
8. Tubat duhet te kene te shenuar daten e skadences ,simolin e sterilizimit ,lotin perkates dhe tipin e antikoagulimit/aditivit qe permbajne.
9. Tubat dhe aksesoret e marrjes se gjakut duhet te jene njeperorimesh.
10. Tubat e perdorur ne kimine klinike, hematologji dhe koagulim duhet patjeter te kene perberje te materialit plastic te pathyshem PET ne menyre qe te shmanget risku I thyerjes apo plasaritjes se tyre gjate centrifugimit.
11. **Afati i skadencës:** Data e skadencës për materialet mjekësore objekt prokurimi, në ditën e lëvrimin të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Loti 2 Materiale per marrjen e mostrave te anatomise patologjike

Nr	Emertimi	Njesia/Paketimi
1	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol . 120 ml - vol 150 ml
2	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol . 500 ml
3	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol 1000 ml
4	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol . 3000 ml
5	Furce per marje materiali Cervikal per testim PAP- test	
6	Kontenitor me kapak dhe terren ruajtes per material Cervikal per PAP - test	
7	Xhama Objekt mbajtes	Fund I zmeriluar
8	Xhama Objekt mbulues	24 mm * 50 mm

9	Kontenitor I vogel steril bosh me kapak kunder rrjedhjes permarrje ne biopsy velikidetepalceskurrizore, biopsive renale, te gjirt etj.	Rreth 60-090 ml
---	--	-----------------

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Argumentimi për specifikimet teknike janë vendosur në baze të materialit të përgatitjes së specifikimeve teknike dhe përlogaritjes së fondit limit me nr. 118/4 prot., dt. 27.02.2023 të përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdherin e brendshëm me nr. 118/2 prot., dt.01.02.2023, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nënvepset 20 dhe 49 të Ligjit nr. 105/2014 “Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik”.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas tabelës së mëposhtme.

Afati i lëvrimit të mallit

Loti I: Tubat duhet të lëvrohen cdo tre muaj për shkak të skadencës të vogël që kanë si pasojë e sistemit të mbyllur, Në momentin e lëvrimit të kenë skadence jo më të vogël se 5 muaj.

Loti II: Malli duhet të lëvrohet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Loti 1. Materiale për marrjen e gjakut

Nr	Emertimi	Volumi, Permasat	Shenime	njesia	sasia
1	Tub me trisodium citrate plasma (0,109M,3,2% per teste koagulimi Sistem I mbyllur me vakum .Tape bojeqielli	2,7-4,5 ml,13x75mm		cope	13,870
2	Tuba me xhel per serum, me aktivator koagulimi te shpejte .Sistem I mbyllur me vakum .Tape Portokalli/e kuqe	5ml,13x100mm	Ndares me xhel ,koha e koagulimit jo me shume se 10 minuta	cope	10,000
3	Tuba me xhel me serum me aktivator kogulimi me kohe jo me te madhe se 30 minuta .Sistem I mbyllur me vakum.Tape e Verdhe/e Kuqe.	5 ml,13x 100mm	Ndares me xhel	cope	18,470
4	Tuba me litium Heparin per plazem ,Sistem I Mbyllur me vakum .Tapa Jeshile	3-4 ml,13x75mm	Ndares me xhel ose ndares mekanik	cope	1,000
5	Tuba me K2EDTA (Dipotaassium) per teste hematologjike,Sistem I mbyllur me vakum .Tape Lejla	3-4 ml,13x75mm		cope	4,560
6	Tuba me K3 EDTA ,Sistem I mbyllur me vakum .Tape Lejla	3-4 ml,13x75mm		cope	31,210
7	Tuba ACD(Acid Citrate Dextrose Tape e Verdhe	8-10 ml 16x100mm	Sasi e vogel vetem per HLA	cope	
8	Tub me sodium citrat per matjen e eritrosedimentacioit (ESR) Tape e zeze	1,6-5ml	Te shoqerohet me stative mbajtes /mates ose me aparatura atomatika te matjes se ESR me kapacitet jo me pak se 60 teste ne ore	cope	3,450

9	Tub pediatrik me K2/K3EDTA per hematologji	me volum 250-500 µl	Te pershtatshem per analizatoret automatik te gjakut	cope	4,600
10	Tub pediatrik me xhel per serum	me volum 400-1000 µl	Te pershtatshem per analizatoret automatik te gjakut	cope	2,600
11	Set Age per marrje gjaku ,te pershtatshem per te gjithë tubat e sistemit me vakum te ofruar	21G ,gjatesia e gjilperes 19mm, gjatesia e tubit jo me e vogel se 17cm.	Rekomandohen sisteme te ages me kapuc per te shmangur kontaminimin dhe me buton terheqes se ages per mbrojtje e personelit nga shpimi aksidental	cope	22,000
12	Shiringe per marrje gjaku me litium heparine	1-3 ml,21-22G	E pershtatshme per gazet ne gjak	cope	5,850
13	Gjilpere shpuese per marrjen e gjakut te foshnjave	23 G	Set age flutur I pershtatshem per moshat pediatrike, neonat per tubat me vakum.	cope	520
14	Zhgut (llastik) per shtrengimin e krahut ku do merret gjaku			cope	100
15	Kontenier plastik steril per koleksionimin e urines me kapak dhe vidhosje qe mbyllet fortesisht	30-60ml ,bosh.	Gotat te jene individualisht te paketuara	cope	6,000
16	Tub me terren per transportin dhe ruajtjen e urines me permbajtje te acidit borik	4-10ml,	per transport dhe ruajtje te mostrave te urines deri ne 48 ore	cope	300
17	Kontenier plastik per koleksionimin e feces i pajisur me spatul dhe kapak dhe vidhosje qe mbyllet fortesisht	20-30ml bosh	Bosh	cope	1,200
18	Kontenier me terren ruajtes te pershtatshem per koleksionimin e feces per testim parazitologjik	30-40ml	terren me permbajtje 10% formaline fiksuese ose ekuivalent	cope	500
19	Kit per koleksionimin dhe ruajtjen e mostrave rektale dhe feces,I perbere nga tamponi dhe tubi me terren Carly Blair	Tampon me tub me terren	i rekomanduar per rastet kur mostra fekale nuk mund te sigurohet ne rruge tradicionale	cope	70
20	Kit steril I pershtatshem per marrjen e mostrave vaginale,fytit,te lekures ,te plageve I pajisur me tampon dhe terren ruajtes per aerobe,anaerobe.	Terren ruajtes me xhel agar Amies ose Stuart me dhe pa charcoal ose ekuivalent	Tamponet te jene me bisht plastik dhe maje me permase normale. Kiti mund te perfshije nje ose 2 tampone dhe tubin me terren. Te kene paketim individual per cdo kit.	cope	2,120

Loti 2 Materiale per marrjen e mostrave te anatomise patologjike

Nr	Emertimi	Njesia/Paketimi	totali sasise
1	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol . 120 ml - vol 150 ml	270
2	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol . 500 ml	160
3	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol 1000 ml	155
4	Kontenitor me formaline per biopsite	Vol . 3000 ml	171
5	Furce per marje materiali Cervikal per testim PAP- test		500
6	Kontenitor me kapak dhe terren ruajtes per material Cervikal per PAP - test		0
7	Xhama Objekt mbajtes	Fund I zmeriluar	500
8	Xhama Objekt mbulues	24 mm * 50 mm	500
9	Kontenitor I vogel steril bosh me kapak kunder rrjedhjes permarrje ne biopsy velikidetepalceskurrizore, biopsive renale, te gjirt etj.	Rreth 60-090 ml	320

Sasia dhe Grafiku i levrimit jane vendosur ne baze te materialit te pergatitjes se specifikimeve teknike dhe perllogaritjes se fondit limit me nr. 118/4 prot., dt. 27.02.2023 te pergatitur nga grupi i punes i ngritur me urdherin e brendshem me nr. 118/2 prot., dt. 01.02.2023, si dhe ne perputhje me piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e levrimit të mallrave.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (Te njejtat per te dyja Lotet)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1

b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: (Te njejtat per te dyja Lotet)

Sipas kriterve të përgjithshme për kualifikim

Kapaciteti ekonomik dhe financiar: (Te njejtat per te dyja Lotet)

Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera e tyre të jete jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit ose shumës së loteve për të cilat konkurren operator.

Kerkesa konsiderohet e permbushur nese operatoret ekonomik arrijne vleren e xhiros minimale ne te pakten 1 vit te periudhes se kerkuar.

*Deshmi nga operatori ekonomik per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo me te vogel se 20%** te vleres së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

- *Autoriteti kontraktor si deshmi per pervojen e meparshme kerkon vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ke shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore ku te shënohen datat,

2.3 Kapaciteti teknik: (Te njejtat per te dyja Lotet)

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001/ose/ ekuivalent ISO 13485 "Per Sistemin e menaxhimin te cilesise" /ose ekuivalent/ të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë. Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- *Ofertuesi duhet te jete i certifikuar me ISO 9001:2015 ose ekuivalente të vlefshme, për fushën e veprimtarisë që përfshin objekti i prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse brenda afatit të vlefshmërisë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*
- *Vetëdeklarimse te gjitha materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) te jene te certifikuara ose markuara CE ose FDA , kur eshte e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar per periudhen që përfshin objekti i prokurimit.*

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

- Vetedeklarim i operatorit ekonomik lidhur me origjinën e mallit, ku të përcaktohet qarte vendi dhe kompania prodhuese.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fushën e objektit të prokurimit.
- Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.
- Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rajonal Durres, të mbyllura me ngjithëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi në oren dhe datën e hapjes së procedurës.
- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
